

Arsimi i Lartë dhe Bota e Punës: Lidhje të reja nëpërmjet Procesit të Bolonjës

*Klemen Miklavič**

Përmbledhje

Ky punim mbështetet mbi diskursin bashkëkohor lidhur me reagimin e institucioneve të arsimit të lartë për nevojat e shoqërisë. Ai reflekton mbi paradigmen e ndryshueshme strategjike në fushën e arsimit të lartë brenda kontekstit modern socio-ekonomik.

Punimi fokusohet në përcaktimin e sërishëm të marrëdhënieve midis punëdhënësve dhe arsimit të lartë të inkurajuar nga Procesi i Bolonjës. Punësimi i të diplomuarve dhe baza e lidhjes midis botës së punës dhe arsimit të lartë është shqyrtuar me vëmendje të veçantë lidhur me rolin dhe rëndësinë e punëdhënësve si aktorët kryesorë në arsimin e lartë.

Përfundimet e punimit janë krahasuar me fazën aktuale të zbatimit të Procesit të Bolonjës në Universitetin e Prishtinës.

Fjalët kyç: Procesi i Bolonjës, arsimi i lartë, ndërkombëtarizimi, evropianizimi, tregu i punës, bota e punës, universitetet, institucionet e arsimit të lartë, njohuria e shoqërisë, Universiteti i Prishtinës.

Hyrje

Shumica e sistemeve të arsimit të lartë në Evropë dhe në institucionet përkatëse të arsimit të lartë kanë bërë hapa drejt Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë - qëllimi i tyre është Procesi

* *Klemen Miklavič ka përfunduar shkallën e tij kërkimore në Universitetin e Lubjanës dhe ka punuar në fushën e politikave të arsimit të lartë më shumë se shtatë vjet, për disa OJQ, institucione të ndryshme dhe qendrat kërkimore si Qendra për Studime të Politikës së Arsimit në Universitetin Lubjanës si dhe Qendrën për Politikën e Arsimit në Beograd. Aktualisht ai është i punësuar në Misionin e OSBE-së në Kosovë si këshilltar i lartë i Arsimit të Lartë. Hulumtimet dhe përfundimet e autorit në punim nuk i përfaqësojnë pikëpamjet e organizatës për të cilën ai punon.*

i Bolonjës. Ka pasur shumë interpretime dhe kurse të zbatimit të iniciativave politike, të cilat si më të shquara transnacionale në historinë evropiane mbase ishin në fushën e arsimit të lartë. Zhvillimet moderne sociale dhe ekonomike kanë luajtur një rol të rëndësishëm në një hap të tillë revolucionar të bërë nga qeveritë evropiane dhe institucionet e arsimit të lartë.

Universitetet janë pjesë e shoqërisë dhe përkundër nivelit të lartë të autonomisë dhe lirisë akademike, duhet të jetojnë me ndryshimin e mjedisit ku ata veprojnë. Megjithatë, shoqëritë demokratike perëndimore janë ndërtuar mbi të njëjtat parime si të universiteteve autonome: diskutimi i lirë, mendimi kritik dhe shkëmbimi i informacioneve. Për fuqizimin demokratik dhe progresin e shoqërisë është me rëndësi vendimtare që jeta e universitetit të jetë autonome. Në anën tjetër, një funksionim i mirë i arsimit të lartë është përcaktues edhe për zhvillimin ekonomik i mishëruar, në thelb, në përparimin e shoqërisë. Prandaj, marrëdhëniet ndërmjet arsimit të lartë dhe botës së punës janë një segment i rëndësishëm i bashkëveprimit ndërmjet arsimit të lartë dhe shoqërisë. Çështje mbetet sesi duhet t'u përgjigjen universitetet pritjeve dhe nevojave të botës moderne të punës. Meqë Procesi i Bolonjës është shfaqur si udhëzues kryesor i reformës në të gjithë Evropën, është interesante për t'i shqyrtuar elementet e reformës së tij që trajton marrëdhëniet ndërmjet arsimit të lartë dhe botës së punës.

Punimi fillon me rrethanat të cilat çojnë në ndryshimet e nevojshme në arsimin e lartë. Paraqiten nevojat e tashme për krijimin e kushteve për përcaktimin e sërishëm të marrëdhënieve ndërmjet tregut të punës dhe institucioneve të arsimit të lartë. Pjesa e dytë trajton Procesin e Bolonjës si ngritëse për reformat e arsimit të lartë në Evropë. Elementet e reformës të cilat adresojnë tregun e punës janë veçuar me qëllim që të zbulohet shkalla e ndikimit në marrëdhëniet ndërmjet arsimit të lartë dhe botës së punës. Pjesa e fundit e punimit përqendrohet në zbatimin e reformës së Bolonjës në universitetin më të madh të Kosovës,¹ në segmentet të cilat më

¹ Ky kapitull është i bazuar kryesisht në studimin e Misionit të OSBE-së në

parë u identifikuan të kenë ndikim në marrëdhëniet ndërmjet arsimit të lartë dhe botës së punës.

Studimi është mbështetur në mjete të tilla si referenca nga studime² të tjera, vëzhgime, dokumente konferencash, informime dhe dokumente të tjera të rëndësishme legislative nga kjo fushë, si dhe analiza nga burime të dyta, si p.sh., letra të tjera.

Marrëdhënia ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe punëdhënësve diskutohet vetëm në lidhje me mësimdhënien dhe trajnimin e burimeve njerëzore. Aktiviteti studim-shkencor, si një nga lidhjet vendimtare mes universiteteve dhe industrisë, nuk është diskutuar në këtë punim.

NDRYSHIMI I KONTEKSTIT TË ARSIMIT TË LARTË NË EVROPEË

Reformat e nënsistemeve të mëdha sociale, siç është arsimi i lartë, janë mishëruar në ndryshimet e kontekstit social-ekonomik të tyre. Autoritetet demokratike veprojnë sipas interesave të grupeve sociale. Vetëm ndryshimet thelbësore në shoqëri tërhiqen në shkallë të madhe nga ndërrimet në institucionet dhe politikat në fushat e politikës me rëndësi thelbësore, siç është arsimi i lartë. Në shoqërinë bashkëkohore evropiane ka një numër të ndryshimeve të mundshme që mund të listohen si faktorë të jashtëm për të inkurajuar një rishqyrtim tërësor të arsimit të lartë. Sigurisht që këto ndryshime të jashtme nuk janë dhe nuk do të jenë të njëjta për të gjitha kontekstet kombëtare, duke qenë kështu subjekt i një morie të variablave të ndryshme të tilla si struktura e ekonomisë, disponibiliteti i burimeve financiare, traditave sociale/kulturore etj. Pavarësisht nga kjo,

Kosovë. OSCE: *A Study on the Implementation of the Bologna Process at the University of Prishtinë/Priština*. Conducted by Dr. Angele Attard, 2009.

² Gjetjet janë pjesërisht të bazuara në dy studime: Miklavič, K. et al: *Bologna Process between the Employers and Higher Education*, Paper presented at *European Labour Market for Academic Graduates Conference 2006*, University of Maastricht, 2006 and Miklavič, K: *Bolonjski proces, pot v modernizacija visokega solstva*. Magistrsko delo. Univerza v Ljubljani, FDV, 2008.

është fakt që në një mënyrë apo në një tjetër, sistemet kanë për t'iu përgjigjur ndryshimeve rreth tyre.³

Siç janë grupuar në Miklavič 2008,⁴ janë tre ndikime të jashtme kryesore që përfaqësojnë kuadrin e ndryshimit të nxitur dhe domosdoshmërinë për ndryshime në arsimin e lartë: 1. masifikimi i arsimit të lartë; 2. njohuria e shoqërisë dhe ekonomisë; 3. globalizimi dhe internacionalizimi i shoqërisë.

1. Masifikimi i arsimit të lartë: Në fund të viteve gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar, ishte e mundur të vëzhgohej fillimi i një rritjeje të konsiderueshme i numrit të regjistrimit në arsimin e lartë. Natyra elitare e studimit në universitete u venit. Arsimi i lartë u hap me të madhe deri në pjesët e çdo brezi. Rritja e shpejtë e numrit të regjistrimit është një nga faktorët bazë të përcaktimit bashkëkohor të arsimit të lartë në Evropë.⁵ Sot, në shumë vende evropiane, më shumë se 50% e çdo grupmoshe regjistrohet në arsimin e lartë.⁶ Kjo dukuri ka ndryshuar rrënjësisht strukturën organizative të komunitetit universitar në mënyrë të pashmangshme dhe ndikon në logjikën e mësimdhënies / të mësuarit / hulumtimit. Edhe pse të ndryshme anembanë Evropës, universiteti tradicional kërkon një përshtatje në këtë realitet.

2. Njohuria e shoqërisë dhe ekonomisë: Njohuria e shoqërisë / ekonomisë është ndoshta një nga sloganet më të përhapura sot në fjalimet politike evropiane, e cila është përdorur shpesh për të portretizuar tranzicionin nga prodhimi industrial me një klasë punëtore me arsimim të ulët në industrisë dhe shërbime në bazë të njohurive dhe duke përfaqësuar të gjithë shtyllën kurrizore të ekonomisë.⁷ Diskursi i njohurisë së shoqërisë / ekonomisë krijon një politikë racionale të caktuar, ndërsa universitetet bëhen një shërbim i ekonomisë dhe bazë për konkurrencën ekonomike.

³ File, J. in Goedegebuure, L: On real time systems, change and challenges. Comparative reflections. V File, J. in Goedegebuure, L (eds.): Real-time systems. Reflections on higher education in the Czech Republic, Hungary, Poland and Slovenia. CHEPS, VUTIUM Press, 2003, f.239.

⁴ Miklavič, K: *Bolonjski proces, pot v modernizacijo visokega solstva*. Magistrsko delo. Univerza v Ljubljani, FDV, 2008.

⁵ Zgaga, P: *Bolonjski proces: oblikovanje skupnega evropskega visokošolskega prostora*. Univerza v Ljubljani, Pedagoška fakulteta, Ljubljana, 2004, f.12.

⁶ OECD: *Education at a Glance*. Published by OECD, 2007.

⁷ Nokkala 2007, Robertson 2005, Van Damme 2002.

Mallrat dhe shërbimet që kërkojnë një input shkencor dhe teknologjik, janë elementet themelore të një ekonomie të fortë.⁸ Në ndryshimin e tregut të punës, ka një tendencë të dukshme për të theksuar kompetencat adekuate të diplomuarit si një nga detyrat prioritare të arsimit të lartë. Çështja e centralizimit të kompetencave në shoqërinë e njohurive e vë universitetin, si një institucion tradicional, përpara sfidave serioze.⁹

3. Globalizimi, ndërkombëtarizimi dhe evropianizimi: globalizimi, si një ndryshim i madh në shoqëri, është ndërthurur në mënyrë të konsiderueshme me njohurinë e shoqërisë / ekonomisë. Në këtë mënyrë, ai ndikon në botën akademike dhe organizimin e arsimit të lartë dhe sjelljet e universiteteve.¹⁰ Gjatë dekadave të fundit ka qenë e mundur të vëzhgohet një rritje e ndërkombëtarizimit të politikave si një reagim i qeverive dhe universiteteve në procesin e globalizimit dhe njohurisë së shoqërisë / ekonomisë.¹¹ Në këtë kontekst ndërkombëtarizimi është gjithashtu pjesë e përgjigjes së arsimit të lartë për globalizimin e tregut të punës.¹²

Van der Wende¹³ e karakterizonte dallimin midis globalizimit dhe ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë duke përcaktuar të dytën si një proces ku autoritetet kombëtare luajnë një rol qendror. Procesi i Bolonjës është një kombinim nga të dy sepse, përveç qeverive, edhe aktorë të tjerë, organizata, si dhe Komisioni Evropian, janë të përfshirë (shih më poshtë). Ky proces hibrid shpesh referohet si evropianizim i arsimit të lartë.

⁸ Morely 2003, Pawlowski 2004, McNay 2006, Bucar 2001, Nokkala 2005.

⁹ Tomusk V: The War of Institutions, Episode I: The Rise, and the Rise of Private Higher Education in Eastern Europe. Higher Education Policy, 16, 2003, f.228.

¹⁰ Nokkala 2007, Van Damme 2002.

¹¹ Nokkala, T: Constructing the Ideal University – The internationalisation of higher education in the comparative knowledge society. Tampere University Press, Tampere, 2007.

¹² Nokkala, T: Knowledge society/knowledge economy discourse in internationalisation of higher education - A Case study in governmentality. Knowledge and Politics Conference, Bergen, Norway 18th to 20th May 2005, f.2.

¹³ Van der Wende, M.C. (2002): *Higher Education Globally: Towards New Frameworks for Research and Policy*. The CHEPs Inaugurals 2002. University of Twente Cheps, 2002,p.49.

NJË PAMJE E PËRGJITHSHME E SHKURTËR E TRENDEVE NË BOTËN E PUNËS

Punimi është e përqendruar në marrëdhëniet mes të arsimit të lartë dhe botës së punës. Prandaj është e rëndësishme të hedhim dritë mbi disa trende të mëdha në botën e punës që kanë të bëjnë me punësimin e të diplomuarve dhe arsimin e lartë në përgjithësi.

Ndryshimet në proceset e teknologjisë dhe globalizimit të ekonomisë kanë krijuar një treg të unifikuar dhe të lidhur me marrëdhënie të ngjashme me ato në tregjet e brendshme.¹⁴ Shkalla e arsimimit të punësuarve luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në kompanitë sa i përket rritjes së konkurrencës duke shtuar vlerën e mallrave të prodhuara dhe shërbimeve. Ajo gjithashtu u ndihmon të punësuarve që të jenë më produktivë, të pavarur, krijues etj. Për shkak të kualifikimeve të larta, ata fitojnë më shumë, janë më të hapur për ndryshime në karrierë dhe përshtaten më shpejt me punë të reja. E vetmja mënyrë për rritjen e mirëqenies, është rritja e nivelit mesatar të arsimimit të punësuarve dhe, natyrisht, të popullsisë në përgjithësi.¹⁵

Me tregun e çrregullt dhe të globalizuar, është rritur nevoja për programe arsimore më të përgjithshme duke theksuar aftësitë fleksibile, funksionale të përshtatshme për shumë lloje të punës. Ndryshimet në procedurat teknologjike janë pasqyruar edhe në strukturën e forcës së punës. Sipas Betcherman, Mc Mullen dhe Davidman¹⁶, ndryshimet e tregut të punës pas-industriale janë rezultate të:

- ndryshimeve në strukturat e punësimit (ritjen e shërbimeve informative dhe rënien e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve tradicionale);
- ndryshimeve në pjesën e pjesëmarrësve të rinj (ritje e numrit të grave të punësuara, të punësuar më të vjetër në tregun e punës);

¹⁴ Kos, M. (2000): Menedžment dodane vrednosti. Teorija in praksa, Ljubljana.

¹⁵ Ibid.

¹⁶ Mirčeva, J: Razvoj izobraževanja na področju dela: kanadske izkušnje in raziskovalni pristopi. Andragoška spoznanja. Let. 6, št. 1, 2001, f.24.

- llojeve të ndryshme të kontratave të punës;
- legalizimit të disa llojeve të punësimit dhe të punës jo-standarde.

Kështu, arsimi i lartë është i rëndësishëm për tregun e punës dhe anasjelltas, pasi ata janë gjithnjë e më shumë të ndërlidhur.

Ne mund të konstatojmë se kushtet aktuale në botën e punës kërkojnë një rritje të bashkëveprimit mes tregut të punës dhe arsimit të lartë. Vendet e punës bashkëkohore kërkojnë forcë punëtore të kualifikuar, ndërsa natyra e punës është gjithnjë e më dinamike.

Prandaj, është e arsyeshme të gjendet një mënyrë efektive për të bërë të mundur komunikimin e institucioneve të arsimit të lartë që t'u përgjigjen kushteve të reja në botën e punës.

PROCESI I BOLONJËS - NJË PËRGJIGJE E POLITIKAVE PËR KONTEKSTIN E NDRYSHUAR

Procesi i Bolonjës është një iniciativë e përbashkët e vendeve të Evropës në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare nga fusha e arsimit, universiteteve, organizatave të studentëve dhe partnerëve socialë. Ai është karakterizuar nga bashkëpunimi dhe unifikimi i metodave për zgjidhjen e sfidave dhe problemeve aktuale në lidhje me konceptet kryesore, zhvillimin e politikave dhe strategjive të arsimit të lartë në procesin e integritimit evropian dhe globalizimit. Procesi ka një histori të gjatë; Ai filloi zyrtarisht me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës (1999) me anën e të cilës (29) shtetet anëtare ranë dakord për krijimin e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (ZEAL) deri në vitin 2010¹⁷.

Vendet të cilat janë pjesë e Procesit të Bolonjës, janë duke zbatuar ndryshimet për të miratuar një sistem të lexueshëm më lehtësisht dhe grada të krahasueshme. Kualifikimet duhet të përshkruhen sipas rezultateve të studentit, kompetencave,

¹⁷ Zgaga, P. (2004): Bolonjski proces: oblikovanje skupnega evropskega visokošolskega prostora. Univerza v Ljubljani, Pedagoška fakulteta, Ljubljana, 2004, f.11.

punës së studentit, nivelit të edukimit dhe profilit të diplomuarit (Berlin Communiqué, 2003; Bologna Working Group, 2005). Kriteret janë të definuara në mjete të standardizuara për transparencë, siç janë kuadri i kualifikimit dhe plotësimi i diplomës. Këto mund të ndihmojnë punëdhënësit që duan të punësojnë të diplomuarit e ardhur nga vendet e ndryshme dhe zotërojnë kualifikime të ndryshme.

Zanafilla dhe përmbajtja e dokumenteve të Bolonjës është më e lehtë për të kuptuar në qoftë se nuk lexohet si një dokument akademik, por si një agjendë për ndryshime në arsimin e lartë të shkaktuara nga mendimet sociale dhe ekonomike¹⁸. Është pa mëdyshje gjithashtu rezultat i integritit në tregun e punës të BE-së si dhe ndryshimeve të tjera të thella në botën e punës. Punësimi u paraqit si një nga konceptet kryesore tashmë në Deklaratën e Bolonjës në 1999 dhe ka qenë e pranishme gjatë gjithë rrugës së zhvillimit të procesit.

Nëse e shohim nga perspektiva të ndryshme, Procesi i Bolonjës ka kontribuar shumë në diskutim për marrëdhëniet mes botës së punës dhe arsimit të lartë.

Teichler¹⁹ e sheh Procesin të Bolonjës si "mundësi reale /.../ për të riorganizuar dhe për të rishikuar marrëdhëniet midis arsimit të lartë dhe botës së punës". Pas nënshkrimit të Deklaratës së Bolonjës, vendet evropiane kanë ndërmarrë veprime për të rritur punësimin e të diplomuarve në tregun kombëtar të punës si dhe atë ndërkombëtar. Ngritja e vetëdijes për nevojën për të siguruar dhe ngritur punësimin e të diplomuarve, inkurajon ndryshime dhe reforma në arsimin e lartë.

¹⁸ Haug, G. The public responsibility for higher education: preparation for the labour market. In Weber, L. & Bergan, S. eds, (2005) The public responsibility for higher education and research. Strasbourg, Council of Europe Publishing, 2005, f.203.

¹⁹ Teichler, U. (2004): Changes in the Relationships between Higher Education and the World of Work on the Way towards the European Higher Education Area. Keynote speech at the EUA Conference "University and Society: Engaging Stakeholders", Marseille, 1-3 April 2004, f. 2.
<http://www.eua.be/eua/jsp//upload/Ulrich%20Teichler%20speech.1080891100325.doc> (10. August 2006)

Thirrja për një reagim më të madh në realitetin e ri në tregun e punës, gjithnjë e më të integruar të BE-së, shfaqet gjithashtu në dokumentet dhe strategjitë e BE-së. Komisioni Evropian (KE) luan një rol të rëndësishëm në avancimin e Procesit të Bolonjës. Një pikë e fortë e KE-së është kombinimi i Procesit të Bolonjës me agjendën e saj në fushën kërkimore në kuadrin e Strategjisë së Lisbonës. "Politikat e saj bëjnë thirrje për aktivitete të arsimit të lartë që t'i përgjigjen » nevojave « të tregut të punës dhe të industrisë".²⁰ Procesi i Bolonjës së bashku me iniciativat strategjike në fushën e kërkimit shkencor në KE, janë të domosdoshme për përmirësimin e mekanizmave për punësimin e të diplomuarve universitarë.²¹ Para takimit të ministrave përgjegjës për arsimin e lartë në Londër (2007), KE deklaroi se inkurajon modernizimin e sistemeve të arsimit të lartë në mënyrë që të përballen me sfidat e globalizimit dhe kërkesat në rritje për kompetenca dhe aftësi në tregun evropian të punës për novacion.²² Kështu, edhe pse aktorët kryesorë të Procesit të Bolonjës janë vendet e Evropës me qeveritë e tyre, Komisioni Evropian është një ndërmjetësues i rëndësishëm ndërqeveritar i strategjive ekonomike dhe zhvillimeve të politikave për punësim brenda BE-së dhe, për këtë arsye, një aktor i konsiderueshëm në Procesin e Bolonjës.

Punëdhënësit janë përfshirë zyrtarisht në Procesin e Bolonjës vetëm në vitin 2005, përmes organizatës përfaqësuese të tyre, edhe pse Bashkimi i Industrisë dhe Konfederatat e Punëdhënësve të Evropës (BIKE) kishin shprehur më parë mendimin rreth Procesit të Bolonjës. Ata presin një lëvizshmëri më të mirë të studentëve, fleksibilitet të studimeve, transparencë më të madhe të diplomave dhe kualifikimeve të

²⁰ Keeling, R. (2006): The Bologna Process and the Lisbon Research Agenda: the European Commission's expanding role in higher education discourse. *European Journal of Education*, Vol. 41, No.2, 2006, f.209.

²¹ Evropska Komisija (2003): Vloga univerz v Evropi znanja. Sporočilo komisije evropskih skupnosti (2003) http://europa.eu.int/eur-lex/en/com/cnc/2003/com2003_0058en01.pdf (27. 3. 2005)

²² European Commission (2007): From Bergen to London. The contribution of the European Commission to the Bologna Process. <http://ec.europa.eu/education/policies/educ/bologna/report06.pdf> (22. 1. 2008)

diplomuarve nga vendet e ndryshme dhe bashkëpunim më të mirë midis institucioneve të arsimit të lartë dhe kompanive të biznesit. Sipas dokumenteve²³ të BIKE-së, njëra nga fushat më të rëndësishme të bashkëpunimit është punësimi i të diplomuarve, gjë që duhet të konsiderohet qysh tash në fazën e planifikimit të programit.

Përkundër përqendrimit të konsiderueshëm në botën moderne të punës, Zona Evropiane e Arsimit të Lartë nuk është e kufizuar vetëm në modernizimin e sistemeve të arsimit të lartë dhe trajnimin për nevojat e zhvillimit ekonomik. Ndryshimet në botën e punës janë vetëm një pjesë e ndryshimeve në shkallë të gjerë në shoqëri që është duke u drejtuar nga Procesi i Bolonjës. Ajo nuk duhet të konsiderohet, pra, si, një strategji politike, duke synuar t'i shërbejë nevojave të korporatave të biznesit dhe ekonomisë moderne. Krahas përgatitjes së individit për tregun e punës, në institucionet e arsimit të lartë, studentët përgatiten të kontribuojnë në rritjen e tyre personale edhe për shtetësi aktive në një shoqëri demokratike, si dhe të mirëmbajnë dhe zhvillojnë një bazë të njohurisë së avancuar.²⁴ "Procesi i Bolonjës është ndërtuar mbi trashëgiminë e universiteteve evropiane, dhe aftësia për t'iu përshtatur rrethanave të ndryshme është një pjesë e kësaj trashëgimie.

Përgjegjësia publike për arsimin e lartë do të thotë gjithashtu ruajtje dhe ndërtim të kësaj trashëgimie për ta përcjellë atë në brezat e ardhshme".²⁵

²³ UNICE (2004): The Bologna Process, UNICE's Position and Expectations (October), <http://www.unice.org/1/PGDNNPDCKGCAAINJHCDHIP-MMPDBK9DWWTk9LI71KM/UNICE/docs/DLS/2004-01874-EN.pdf> (30. 8. 2006)

²⁴ Bergan, S: Higher education as a "public good and public responsibility": what does it mean? In Weber, L. & Bergan, S. eds, (2005) The public responsibility for higher education and research. Strasbourg, Council of Europe Publishing, 2005, f. 27.

²⁵ Ibid, f. 25.

PROCESI I BOLONJËS NDËRMJET BOTËS SË PUNËS DHE ARSIMIT TË LARTË

Një analizë e thellë e dokumenteve të lidhura me Procesin e Bolonjës tregon një referencë të qartë dhe të vazhdueshme të reformave në tregun e punës.²⁶ Evropianizimi i arsimit të lartë për këtë arsye është duke synuar ripërcaktimin e marrëdhënieve mes botës së punës dhe arsimit të lartë. Përfshirja e organizatave të punëdhënësve në proces e konfirmon interesin në rritje nga ana tjetër - bota e punës - gjithashtu për arsimin e lartë.

Protagonistët e reformave të Bolonjës janë universitetet dhe në një shkallë të caktuar edhe qeveritë. Hapi vendimtar drejt ndryshimit të marrëdhënieve mes arsimit të lartë dhe botës së punës varet, pra, nga komuniteti akademik dhe autoritetet demokratike. Prosesi i Bolonjës ofron një kuadër të gjerë mbarevropian në mënyrë që të lehtësohet ky hap. Në mesin e një morie taksash dhe elemente reformash mund të dallojmë ato tre më kryesoret që adresojnë lidhjen midis punëdhënësve dhe arsimit të lartë²⁷: 1. lëvizshmëria e studentëve; 2. përfshirja e aktorëve kryesorë në struktura dhe procese; 3. struktura e re e gradave dhe punësimi si një koncept gjithnjë e më i përhapur. Në paragrafët e ardhshëm janë përshkruar të tre këta elementë.

1. Lëvizshmëria e studentëve

Lëvizshmëria e studentëve në gjithë zonën evropiane të arsimit të lartë është qëllim strategjik i tërthortë i Procesit të Bolonjës. Shumica e mjeteve dhe elementeve synojnë lehtësimin e lëvizshmërisë së studentëve, personelit akademik dhe hulumtuesve jashtë kufijve (ECTS, diploma shtojcë, kuadro të kualifikimeve, konventë të njohjes etj.) Ideja e lëvizshmërisë në shkallë të madhe të nxënësve në Evropë datohet në nismat e Komisionit Evropian në vitet tetëdhjetë (Socrates Erasmus Programme) dhe ka qenë qëllimi më i madh politik mes Procesit të

²⁶ Miklavič, K: Bolonjski proces, pot v modernizacija visokega solstva. Magistrsko delo. Univerza v Ljubljani, FDV, 2008, f.86.

²⁷ Ibid. p. 86-92.

Bolonjës dhe iniciativave të Komisionit Evropian në fushën e tregut të punës.²⁸ Në dy dekadat e fundit studimet tregojnë lidhje reciproke mes lëvizshmërisë së studentëve dhe punësimit.²⁹ Një student mobil është më mirë i përgatitur për t'u integruar në tregun e punës së BE-së dhe ekonominë e globalizuar. Aftësitë dhe kompetencat e fituara nga përcaktimet e ndryshme kulturore përbëjnë një avantazh në përshtatjen me punë në shtete të ndryshme. Punëdhënësit theksojnë rëndësinë e lëvizshmërisë së studentëve përmes organizatave të tyre përfaqësuese.³⁰

2. Përfshirja e aktorëve kryesorë në struktura dhe procese

Procesi i Bolonjës është një lloj forumi demokratik i përbërë nga shumë anëtarë të ndryshëm. Forumi i cili, fillimisht, u paraqit nga ministrat evropianë, zgjeroi anëtarësimin e tij, duke përfshirë jo vetëm vendet e reja (në 2001, 2003 dhe 2005) dhe Komisionin Evropian (2001), por edhe OJQ-të (në vitin 2001 dhe 2003) dhe partnerët socialë (në 2005-shih më poshtë).

Ndikimi i institucioneve evropiane të arsimit të lartë dhe studentëve është më i përhapur në këtë forum por, kohët e fundit, edhe me ndikimin e sindikatave dhe punëdhënësve organizata mund të njihet.³¹

Për shkak të përfshirjes aktive dhe rolit të dhënë nga ministrat, aktorët e lartpërmendur kanë ndikuar konsiderueshëm në kursin e Procesit të Bolonjës.³² Kjo në të vërtetë dërgoi një sinjal në nivel kombëtar dhe promovoi përfshirjen e tyre aktive në fazën e

²⁸ Haug, G: The public responsibility for higher education: preparation for the labour market. In Weber, L. & Bergan, S. eds, The public responsibility for higher education and research. Strasbourg, Council of Europe Publishing, 2005.

²⁹ Haug 2005, Teichler 1999.

³⁰ UNICE: The Bologna Process, UNICE's Position and Expectations (October 2004). <http://www.unice.org/1/PGDNNPDCKGCAAINJHCDHIPMMP-DBK9DWWTk9LI71KM/UNICE/docs/DLS/2004-01874-EN.pdf> (30.8.2006)

³¹ Zgaga, P: Bolonjski proces: oblikovanje skupnega evropskega visokošolskega prostora. Univerza v Ljubljani, Pedagoška fakulteta, Ljubljana, 2004.

³² Miklavič, K.: Bolonjski proces, pot v modernizacijo visokega solstva. Magistrsko delo. Univerza v Ljubljani, FDV, 2008.

përfshirjes së elementeve të Bolonjës në sistemin kombëtar të arsimit të lartë. Prezenca e përhershme e palëve të interesuara në arsimin e lartë ndahet kryesisht në dy nivele. Në nivelin institucional ata shpesh përfshihen në borde të universiteteve ose organeve të ngjashme, ndërkaq në nivelin e sistemit kanë rol edhe më të rëndësishëm brenda strukturave të sigurimit të cilësisë. Kjo e fundit ka qenë e inkurajuar edhe nga përfshirja e palëve të interesuara në nivel evropian në krijimin e Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë.

Duket se punëdhënësit në Evropë janë përfshirë në Procesin e Bolonjës relativisht ngadalë. Pavarësisht nga pikëpamjet e tij tashmë ekzistuese (UNICE, 2004), UNICE zyrtarisht ishte përfshirë në Procesin e Bolonjës si një anëtar konsultativ në Konferencën e ministrave përgjegjës për arsimin e lartë në Bergen në maj 2005³³. Deri atëherë, punëdhënësit u konsideruan absolutisht si "një grup interesi" ose "partnerë".

Përfaqësuesit e UNICE-it shprehin shumë qartë shpresat e mëdha që kanë ata në të dyja proceset që kanë të bëjnë me reformat e arsimit të lartë. Kur flitet për Strategjinë e Lisbonës së BE-së, ata theksojnë hulumtimet universitare³⁴ dhe propozojnë zgjidhje më të gjerë dhe të hollësishme për një lidhje më të ndërmjet arsimit të lartë dhe botës së punës. Jo vetëm në praktikën e kompanisë, por edhe mësuesit që vijnë nga profesioni, studimet e rastit si dhe ekspertët e fushë, duhet të përfshihen në zhvillimin e programeve të studimit dhe të kurrikulave.³⁵ Punëdhënësit kërkojnë programe studimi më fleksibël për të rritur më shumë lëvizshmërinë e studentëve që mund të përmirësojnë lëvizshmërinë e të diplomuarve ose të fuqisë punëtore të

³³ Bergen Communiqué: The European higher Education Area- Achieving the Goals. Conference of Ministers responsible for Higher Education in 40 European countries (May 2005).

³⁴ UNICE: Lisbon Strategy; Status 2003; Time is Running Out, Action needed now, 2003. <http://212.3.246.117/1/CFNHMHBCFHEMMIAFMKHPNC-APDB69DB1CG9LI71KM/UNICE/docs/DLS/2003-00589-EN.pdf> (30.8.2006).

³⁵ UNICE (2004): The Bologna Process, UNICE's Position and Expectations (October), <http://www.unice.org/1/PGDNNPDCKGCAAINJHCDHIP-MMPDBK9DWWTK9LI71KM/UNICE/docs/DLS/2004-01874-EN.pdf> (30. 8. 2006).

kualifikuar.³⁶ Krahas njohurive të veçanta subjektive, të diplomuarit duhet të kenë aftësi për të kontribuar në fleksibilitetin e natyrës së ndryshme dhe komplekse të punës. Punësimi dhe lëvizshmëria e të diplomuarve janë motive vendimtare për të përfshirë punëdhënësit evropianë në reformat e arsimit të lartë.

Shtrohet pyetja nëse me përfshirjen e aktorëve të jashtëm në arsimin e lartë vihen në rrezik disa funksione thelbësore të arsimit universitar dhe shoqërisë. Kërkesa për një reagim të gjerë të universiteteve për nevojat e industrisë në njërën anë dhe funksionet kryesore të universitetit nga ana tjetër, mund të çojnë në konflikte të mundshme.

3. Struktura e re e diplomimit dhe punësimi si koncept gjithnjë e më i përhapur

Koncepti i punësimit paraqitet në të gjitha dokumentet zyrtare të Procesit të Bolonjës si koncept kyç, të cilit i është dhënë prioritet në reformën e arsimit të lartë në vendet e Evropës. Megjithatë, për shkak të metodave të ndryshme për përkufizimin e konceptit, asnjë marrëveshje nuk është arritur në lidhje me kuptimin e vërtetë për punësim në këtë kohë.

Mundësia për punësim absolutisht nuk mund të përshkruhet si punësim dhe - siç është miratuar nga shumica e autorëve - thjesht nuk mund të matet nga shkalla e punësimit e të diplomuarve që kanë përfunduar arsimin e lartë. Koordinimi Britanik për Zgjerimin e Mundësive për Punësim të Studentëve (KBZMPS) përdor përkufizimin e mëposhtëm për fjalën mundësi për punësim: "një sërë arritjeje - aftësi, mirëkuptime dhe attribute personale - që u ofron të diplomuarve më shumë gjasa për t'u punësuar dhe për të qenë të suksesshëm në profesionet e tyre të zgjedhura, nga të cilat përfitojnë vetë ata, fuqia punëtore, komuniteti dhe ekonomia".³⁷ Mundësia për punësimin e të

³⁶ UNICE (2005): Position on Commissions Consultation on a European Qualifications Framework for Lifelong-Learning. <http://www.unice.org/1/KCPJHDKCJDHEDKFCNLCKAANNPDB19DWG9LI71KM/UNICE/docs/DLS/2005-01981-EN.pdf> (30.8.2006).

³⁷ Yorke, M. & Knight, P.T: The Undergraduate Curriculum and Employability, a briefing pape, 2003. f.2., <http://www.ltsn.ac.uk/>

diplomuarve ndikohet nga: përvoja e punës individuale, aftësitë për ndërtimin e moduleve në programet e arsimit të lartë, shërbimi për karrierë gjatë studimeve, portofolat ose përparimi i arritur gjatë studimit.³⁸

Sipas Teichler,³⁹ individët bashkëkohorë të cilët dëshirojnë të përmirësojnë mundësitë për punësim duhet të jenë në gjendje të:

- transferojnë njohuritë për të punuar dhe për të kuptuar se çfarë kërkojnë detyrat në punën e tyre që ato të merren me sukses ("aftësitë për zgjidhje të problemeve"),
- zhvillojnë stile tipike të punës (p.sh. puna nën presion, puna pa përcaktuar qartë detyrat),
- ndjekin disa vlera dhe kompetenca efektive përkatëse për punë ("besnikëri", "orientim në arritje", etj.),
- punojnë në kuadro sociale dhe prandaj të kenë "aftësi sociale" ("udhëheqje", "puna në kolektiv" etj. aftësi),
- kuptojnë kontekstin në të cilin ata veprojnë dhe duhet të zgjedhin mënyrat e përshtatshme të veprimit ("përshtatje", "pasqyrim" etj.)

Teichler nxjerr përfundimin se "arsimi i lartë duhet të jetë më aktiv se kurrë më parë për të nxitur këto kompetenca".

Knight dhe Yorke⁴⁰ ndajnë mendimin se mundësia për punësim mund të arrihet përmes qasjeve të ndryshme të të mësuarit në bazë të faktorëve të ndryshëm, siç janë: teoria e vetëzhvillimit dhe vetëpërmbytjes, pasqyrim dhe ndërveprime të tjera sociale. Nga ky këndvështrim, mundësia për punësim duhet të zhvillohet nga ata që janë përgjegjës për kurrikula. Me fjalë të tjera, mundësia për punësim mund të bëhet pjesë e një plan-programi ose mund të arrihet nëpërmjet mësimi të

application.asp?app=resources.asp&process=full_record§ion=generic&id=248 (10 august 2006).

³⁸ Knight, P.T. & Yorke, M: *Employability and Good Learning in Higher Education, teaching in Higher Education*, Vol. 8, No.1, 2003, f.4.

³⁹ Teichler, U: *Changes in the Relationships between Higher Education and the World of Work on the Way towards the European Higher Education Area. Keynote speech at the EUA Conference "University and Society: Engaging Stakeholders"*, Marseille, 1-3 April 2004, f.6.
<http://www.eua.be/eua/jsp//upload/Ulrich%20Teichler%20speech.1080891100325.doc> (10. August 2006).

⁴⁰ Ibid.

adaptimit organizativ dhe metodave arsimore si dhe planifikimit të programit mësimor.

Nga këndvështrimi i punëdhënësve, UNICE i vë mundësitë për punësim në qendër të sistemit të arsimit të lartë. Dokumentet e UNICE-së bëjnë thirrje për më shumë rëndësi në aftësitë dhe kompetencat ndër-disiplinore⁴¹ të fituara gjatë kohës së studimit. Sipas tyre, aftësitë dhe këto kompetenca duhet të arrihen me një bashkëpunim më të ngushtë me kompanitë në përpilimin e programeve mësimore dhe në zhvillimin e programeve.⁴²

Përfundime të ngjashme mund të arrihen nga Reforma e Bolonjës: përveç studimeve të reformuara, strukturave dhe mjeteve të aplikuara që përdoren për transparencë të kualifikimeve, Reforma e Bolonjës ofron gjithashtu mundësi për të futur mësimin/mësimdhënien e orientuar kah studentët, metoda të reja mësimore, arritje të orientuara në mësim, modulim të kurrikulave dhe të ngjashme.⁴³ Kjo pjesë e Procesit të Bolonjës është një komponent i rëndësishëm i cili stimulon indirekt hapjen e sistemeve të arsimit të lartë drejt tregut të punës. Reformat nuk kërkojnë përfshirjen e drejtpërdrejtë të punëdhënësve por, mbi të gjitha, veprim të gjerë nga zhvilluesit e programeve në institucionet e arsimit të lartë. Përqendrimi i Procesit të Bolonjës në mundësitë për punësim, si i tillë, nuk nënkupton një pushtim të funksionimit autonom të universiteteve në mësimdhënie dhe të kërkimit shkencor apo pushtimit të drejtpërdrejtë të punëdhënësve në fushën e lirisë akademike.

Ka një diskutim intensiv në pjesën më të madhe të vendeve nënshkruese të Bolonjës mbi rolin e diplomës së nivelit bachelor brenda strukturës së re. Mundësia për punësim në nivelin bachelor po bëhet një kategori relevante për akreditim të

⁴¹ Ky term nuk përfshin studime të veçanta, por aftësi të përgjithshme. Ata gjithashtu shpesh përkrahohen si: aftësive gjenerike, aftësi të transferueshme dhe shkathësi të përgjithshme.

⁴² UNICE: The Bologna Process, UNICE's Position and Expectations (October 2004), <http://www.unice.org/1/PGDNNPDCKGCAAINJHCDHIPMM-PDBK9DWWTK9LI7IKM/UNICE/docs/DLS/2004-01874-EN.pdf> (30.8.2006)

⁴³ Reichert, S. & Tauch, C: European Universities Implementing Bologna. EUA Trends IV Report . European University Association, Brussels, 2005.

programeve të studimit,⁴⁴ ndërkaq Procesi i Bolonjës përkrah qeveritë që të angazhohen për të ndryshuar rregullat për punësim në administratën publike në favor të të diplomuarve bachelor.⁴⁵ Përkundër konsensusit zyrtar ka probleme të konsiderueshme mbi nivelin e zbatimit. Disa raporte të Bashkësisë Evropiane Universitare⁴⁶ sjellin problemin e ciklit të shkallës së parë të paplotë dhe interpretime të ndryshme mbi rolin e nivelit bachelor. Niveli bachelor shpesh perceptohet si një pauzë ndërmjetëse në rrugën drejt një "shkalle të vërtetë" (master), ose është i mbingarkuar për shkak të ndryshimit të sistemit të vjetër në një periudhë të shkurtër kohore. Pas disa viteve funksionimi me Procesin e Bolonjës u pa që diplomimi i reformuar ka qenë një nga ndryshimet më të mëdha konceptuale në arsimin e lartë. Ai ndoshta do të kërkojë më shumë kohë dhe përpjekje të komunitetit akademik që ta pranojë ndryshimin e propozuar dhe të tregut të punës, për të kuptuar ndryshimin paradigmë në lidhje me strukturën e re dhe shkallën përkatëse të diplomimit.

REFORMA E BOLONJËS NDIKON NË LIDHJET NDËRMJET BOTËS SË PUNËS DHE ARSIMIT TË LARTË NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Procesi i Bolonjës sugjeron që reformat e menduara ta bëjnë arsimin e lartë më të përgjegjshëm ndaj nevojave të tregut të punës moderne. Megjithatë, vlen të theksohet se roli i arsimit të lartë, në veçanti në rastin e Kosovës, është në mënyrë të konsiderueshme më ndryshe se në pjesën më të madhe të zonës evropiane të arsimit të lartë. Një funksionim i tillë në një periudhë të pasluftës kërkon një ristrukturim të shoqërisë, forcim të demokracisë, të shoqërisë civile etj. Prandaj është

⁴⁴ Haug, G: The public responsibility for higher education: preparation for the labour market. In Weber, L. & Bergan, S. eds, (2005) The public responsibility for higher education and research. Strasbourg, Council of Europe Publishing, 2005, f.206.

⁴⁵ Bergen Communiqué: The European higher Education Area- Achieving the Goals. Conference of Ministers responsible for Higher Education in 40 European countries, May 2005.

⁴⁶ Reichert and Tauch 2003, Reichert and Tauch 2005.

vështirë për të bërë një krahasim linear ndërmjet qëllimeve dhe arritjeve të mjedisëve politike kaq të ndryshme.

Megjithatë, roli i arsimit të lartë është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe për nevojat e tregut të punës, pavarësisht nga veçoritë që mund t'i ketë. Pas analizës mbi rolin e Procesit të Bolonjës në revizionimin e marrëdhënieve mes arsimit të lartë dhe botës së punës, unë do të nxjerr në pah zbatimin e reformës së Bolonjës në Universitetin e Prishtinës, në segmentet që janë veçuar më sipër. Ka pasur pak kërkime mbi zbatimin e procesit të Bolonjës në Kosovë dhe madje edhe më pak mbi zhvillimin e tregut kosovar të punës. Prandaj ky punim do të jetë i kufizuar në fushën e kërkimit shkencor në bazë të raportit të bërë nga misioni i OSBE-së në Kosovë⁴⁷ duke iu referuar nga këtu si *Studimi i OSBE-së*.

Lëvizshmëria e Studentëve

Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (ZMN) e Universitetit të Prishtinës, nën drejtimin e Prorektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, është e angazhuar në sigurimin e mundësive për programe të lëvizshmërisë afatshkurtra apo afatgjata dhe gjithashtu për shkëmbimin ndërkombëtar nëpërmjet organizatës për kurse intensive, trajnime, seminare dhe projekte studimi. ZMN-ja gjithashtu ka caktuar aktivitete për punën e njëjësive operative speciale me një fokus në lëvizshmërinë e stafit akademik dhe të studentëve. Ajo ka për qëllim të ofrojë staf akademik me përvoja ndërkombëtare, për të integruar programet ndërkombëtare në kurrikula, dhe për të ngritur një qendër për kërkime shkencore. Ajo gjithashtu synon të rrisë mundësitë për studentët për të studiuar jashtë vendit dhe për të përmirësuar ndërkombëtarizimin e universitetit, veçanërisht nëpërmjet Universitetit Veror të Prishtinës (UVP).

Pjesa më e madhe e mjeteve të tilla, si transparenca e ECTS-ve dhe diplomave shtesë, janë duke u zhvilluar në të gjithë

⁴⁷ OSCE 2009: A Study on the Implementation of the Bologna Process at the University of Prishtinë/Priština. OSCE Mission in Kosovo (performed by Dr. Angele Attard).

universitetin. Megjithatë këto elemente janë zbatuar në letër dhe janë më pak funksionale kur është fjala për përdorimin praktik. Ka vetëm një mundësi të vogël të njohjes së pjesëve të studimit si zëvendësime për kurset e përshkruara brenda universitetit mbi kthimin e studentëve të lëvizshëm.

Mendimet e marra nga pjesëmarrësit e intervistuar gjatë zhvillimit të studimit të OSBE-së tregojnë se ka *pengesa për të dy palët, stafin akademik dhe studentët e lëvizshëm*, të cilat shfaqen në dy forma kryesore, siç janë: *kërkesat e udhëtimit* (sidomos *kërkesa e vizave*) dhe *pengesat e gjuhës*, pasi që ka një numër të madh të studentëve dhe stafit në universitet të cilët nuk janë në gjendje të flasin ndonjë gjuhë tjetër, përveç asaj amtare. Për më tepër, universiteti aktualisht nuk ofron *programe të përbashkëta studimi*, prandaj nuk ka asnjë mundësi për studentët ose personelin për të përfituar nga programet e tilla të cilat, nga ana e tjetër, ofrojnë një mundësi për lëvizshmëri.

Përfshirja e punëdhënësve në strukturat dhe proceset

Në të njëjtën mënyrë sikurse përsërisin edhe ministrat evropianë, në të gjithë Komunikatën e Procesit të Bolonjës, angazhimi i tyre për të punuar me palët e interesuara, përkatësisht me institucionet e arsimit të lartë, organizatat që përfaqësojnë partnerët e biznesit dhe ata socialë në nivelin evropian, pritet që ministrat të përsërisin gjithashtu pjesëmarrjen dhe nivelin e zbatimit të Procesit të Bolonjës brenda vendit. Nga ana e tyre, institucionet e arsimit të lartë, janë përfshirë në përpjekjet nga ministria për zbatimin e procesit dhe, për të mbajtur veten e tyre, janë parimet e partneritetit në kuadër të procesit, të cilat e bëjnë më të mirë për zbatimin e Procesit të Bolonjës në kuadër të institucionit përkatës të arsimit të lartë.

Universiteti ka marrëdhënie shumë të mira me disa ndërmarrje komerciale në Kosovë (për qëllim të praktikantëve). Megjithatë, ndërsa disa përfaqësues të tregut të punës janë të përfshirë në një numër të projekteve të universitetit, reague të marra gjatë këtij studimi tregojnë se universiteti e konsideron bashkëpunimin e saj me industrinë të papërshtatshëm. Kjo është edhe për shkak të mungesës së kërkimit shkencor në

universitet, i cili mund të jetë zonë primare për bashkëpunim ndërmjet universitetit dhe industrisë, përveç ofrimit të punës praktike për studentët nga industria. Universitetit i mungon edhe bashkëpunimi me industrinë në zhvillimin e kurrikulave.

Struktura e re e diplomimit dhe mundësia e punësimit

Universiteti i Prishtinës ka filluar me zbatimin e sistemit me tre cikle duke u përpjekur kështu për t'u lidhur në procesin e Bolonjës që nga viti 2001. Kjo linjë veprimi është konsideruar të jetë fusha në të cilën universiteti është më i përparuar në procesin e reformës. Statuti i Universitetit parasheh dispozita për sistemit e programeve prej tre-ciklesh, duke u referuar veçanërisht në studimet bachelor, master dhe doktoratë.⁴⁸ Ligji mbi arsimin e lartë në Kosovë gjithashtu parashikon strukturën prej tre shkallësh.

Shoqërues me fillimin e vitit akademik 2008 / 9, Universitetit i Prishtinës migroi nga sistemi i vjetër në sistemin e ri tre shkallësh për studime bachelor, master dhe doktoratë. Me dallim nga kjo, sistemin e vjetër e përbënin llojet e programeve të mëposhtme:

- një program prej katër deri në pesë vjet të shkallës së parë;
- një program dyvjeçar për shkallën e *Magjistraturës*, program ky i cili zakonisht bëhej nga hulumtimet, dhe
- një shkallë e hulumtimit dyvjeçar, e njohur si *PhD*.

Lloji i ri i shkallës së parë (bachelor) është një program me një kohëzgjatje kryesisht prej tre vjetësh. Ka disa përjashtime nga ky rregull. Ndër këto përjashtime, është fakulteti i mjekësisë, fakulteti i bujqësisë dhe veterinarisë, fakulteti i shkencave matematikore dhe natyrore, fakulteti i edukimit dhe fakulteti i filologjisë.

Studimi i OSBE-së tregon se shkalla e parë e programeve është pranuar dhe kuptuar përgjithësisht mirë në të gjithë universitetin. Megjithatë, edhe pse struktura tre shkallësh është

⁴⁸ University of Prishtinë/Priština: Statute of the University of Prishtinë/Priština. Prishtinë/Priština, University of Prishtinë/Priština, 2004, f.64.

miratuar, disa anëtarë të stafit akademik të universitetit janë ende duke luftuar për të kuptuar disa dallime kryesore mes regjimit të vjetër dhe të ri të shkallës së diplomimit. Studimi ka identifikuar një numër çështjesh në këtë drejtim. Ndër këto, gjatë dy fazave të para të programit të reformës (2002, 2004), disa anëtarë të stafit akademik të vjetër thjesht e kanë ndarë llojin të shkallës së parë në dy - tre vitet e para që kanë të bëjnë me studimet bachelor dhe dy vitet e fundit kanë të bëjnë me studimet master. Kjo lë dyshime të konsiderueshme rreth mundësive për punësimin e të diplomuarve në shkallën bachelor.

Përmirësimet në një situatë të tillë erdhën me reformën e fundit të programit që filloi në vitin 2006. Reagimet e marra gjatë studimit të OSBE-së tregojnë se një numër i madh i stafit akademik i konsideron diplomat e marra në nivelin bachelor si të përgjithshme, pa ndonjë shkallë specializimi, dhe ata i konsiderojnë të diplomuar studentët që kanë arritur nivelin e fundit vetëm nëse kanë arritur shkallën e parë në kuadrin e sistemit të vjetër dhe kur ata do të kenë përfunduar shkallën e dytë nën sistemin e ri. Ky problem është shtuar për shkak të furnizimit të kufizuar në programin master në universitet, siç tregohet më poshtë. Në veçanti, disa anëtarë të stafit akademik ende e kanë të vështirë për të kuptuar dallimin mes programit të vjetër *magjistër* dhe atij të ri *master*. Kjo mungesë e kuptimit bëhet e qartë veçanërisht kur marrim parasysh që programet *master* janë të një natyre të aplikuar ose profesionale, ndërsa komponentët kërkimorë i takojnë kryesisht programeve të vjetra të *magjistraturës*.

Rezultatet e marra gjatë studimit të OSBE-së tregojnë se angazhimi i përfaqësuesve të tregut të punës është një komponent që mungon në zhvillimin e kurrikulave. Nga ana e tjetër, kurrikulat nuk hartohen me qëllim që të krijojnë mundësi punësimi për të diplomuarit, veçanërisht në nivelin bachelor të studimeve, gjë që bën një numër të madh të profesorëve t'i shohin studimet e shkallës së parë si shumë të përgjithshme dhe të papërshtatshme për përgatitjen e studentëve për në tregun e punës meqë janë më të shkurtra se studimet e shkallës së parë që u zbatuan në kuadrin e strukturës së vjetër në universitet. Ky krahasim tani i bërë në këtë drejtim do të thotë se shkalla e

tanishme e kualifikimit është ekuivalente me stilin të vjetër të shkollës së mesme (p.sh. kualifikimi i inxhinierit) dhe jo si stili i vjetër i parë për studim (p.sh. diplomë inxhinier), me dallim se ky i fundit ishte më i specializuar, zgjaste më shumë dhe ishte një kualifikim i marrë nga një universitet, në krahasim me ish llojin e kualifikimeve të marra nga një lloj shkolle të mesme profesionale. Ky krahasim është i dëmshëm, dhe nuk është në përputhje me qëllimet e shkollës së parë, e cila sipas komunikatës së Bolonjës parasheh sigurimin e hyrjes në tregun e punës, si dhe të arsimit të mëtejshëm. Ky krahasim është edhe më i dëmshëm kur bëhet nga profesorët, të cilët janë personat e ngarkuar me projektimin e kurrikulave.

Qendra e LINK-ut (Shërbimi i Studentëve) në Universitetin e Prishtinës, ka intensifikuar me të madhe ofertat për vende të punës praktike dhe pas diplomimit punësim për studentët e universitetit dhe të diplomuarit. Vendet për punën praktike të studentëve kryesisht janë në institucionet publike si PTK-ja (Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës), KEK-u (Korporata Energjetike e Kosovës) dhe aeroporti, gjykatat dhe bankat komerciale në Kosovë. LINK-u ndjek punën praktike të studentëve për të siguruar kënaqësinë e të dy palëve, të studentëve dhe të punëdhënësit, dhe ofron trajnim në punëgjetje, aftësi për shkrim të CV-ve dhe fusha të tjera të lidhura me punësimin. Universiteti gjithashtu iu organizon studentëve vende të punës për praktikë nën kuadrin e projekteve të organizatave ndërkombëtare të pranishme në Kosovë. Deri më tani, ka pasur pak ose aspak raste të përfshirjes së industrisë në zhvillimin e programit mësimor, edhe pse, për sa i përket sigurimit të cilësisë për vlerësim të brendshëm në bazë të fakulteteve, pritet të përfshihet edhe një përfaqësues i tregut të punës.

Pavarësisht nga përpjekjet e universitetit dhe qendrës LINK, çështja e mundësive për punësim të diplomuarve mbetet një sfidë, për shkak të arsyeve të lartpërmendura, si dhe për shkak të mungesës së përgjithshme të dijenisë së studentëve lidhje me ekzistimin e LINK-ut, dhe, më e rëndësishmja, për shkak të mungesës së lidhjes midis dispozitave të arsimit të lartë të ofruara nga universiteti dhe nga kërkesat e tregut të punës. Të dhënat statistikore mbi tregun e punës janë të dobëta, nuk janë

të studiuara mirë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, por edhe Universiteti, nuk i merr në konsideratë nevojat e tregut të punës kur e përcaktojnë profilin dhe punën e universitetit.

PËRFUNDIM DHE DISKUTIM

Procesi i Bolonjës mund të përshkruhet si një iniciativë politike e qeverive evropiane përfshirë palët e interesuara relevante në arsimin e lartë dhe të Komisionit Evropian. Prandaj, që të dy komponentët ndërqeveritarë dhe kombëtarë synojnë ta sinkronizojnë sistemin evropian të arsimit të lartë. Krijta e madhe e numrit të regjistrimeve, roli gjithnjë e më qendror për njohuri të ekonomisë dhe shoqërisë dhe globalizimi i shfrenuar, ndryshojnë në mënyrë dramatike edhe përcaktimin për universitete moderne dhe institucione të arsimit të lartë. Procesi i Bolonjës është një përgjigje politike për ndryshimin e kontekstit socio-ekonomik dhe i cili i drejton marrëdhëniet mes arsimit të lartë dhe botës së punës në masë të konsiderueshme përmes ecurive të ndryshme.

Punëdhënësit presin që Reforma e Bolonjës të përmirësojë transparencën e kualifikimeve dhe lëvizshmërinë e studentëve. Me miratimin e mjeteve të transparencës dhe futjen e gradave të krahasueshme, pritjet që lëvizshmëria e studentëve të marrë përmasa të reja. Kjo do të kontribuojë në fleksibilitetin, lëvizshmërinë dhe përshtatshmërinë e të diplomuarve në rrethana të ndryshme kulturore dhe të ndihmojë gatishmërinë për t'u integruar në tregjet evropiane dhe globale të punës.

Përfshirja e aktorëve kryesorë është një nga parimet udhëzuese e Procesit të Bolonjës. Në mesin e aktorëve pjesëmarrës janë edhe punëdhënësit. Dokumentet e UNICE-së zbulojnë se punëdhënësit e shohin rëndësinë e Procesit të Bolonjës në nivelin evropian të lëvizshmërisë dhe transparencës së kualifikimeve si dhe, duke përfshirë mundësitë për punësim, si një nga kriteret e programit të studimeve. Me zhvillimin e Reformës së Bolonjës janë përfshirë aktorët kryesorë në strukturat kombëtare të arsimit të lartë të tilla si në sigurimin e cilësisë dhe qeverisjen universitare.

Njëri nga konceptet kryesore të Procesit të Bolonjës është koncepti për punësim. Ky po bëhet një nga elementet themelore të programeve mësimore. Prandaj, përgjegjësia për zbatimin e përshtatshëm të strategjisë për punësim qëndron në duart e institucioneve të arsimit të lartë dhe komunitetit akademik. Punësimi është ngulitur kryesisht në strukturën e re të diplomimit me rëndësi të veçantë në nivelin master. Megjithatë, për shkak të madhësisë së zhvendosjes nga struktura e vjetër në atë të re të diplomimit, do të kalojë më shumë kohë dhe kushtojë disa përpjekje që ajo të absorbohet nga komuniteti akademik, punëdhënësit dhe shoqëria në përgjithësi. Studimet bachelor me diplomë përfundimtare, në mënyrë që i diplomuari të jetë gati për tregun e punës, është një nga objektivat më sfiduese të politikave të Procesit të Bolonjës.

Riorganizimi i marrëdhënieve ndërmjet punëdhënësve dhe arsimit të lartë është absolutisht i nevojshëm dhe i logjikshëm. Megjithatë, duhet të bëhen më shumë përpjekje për të përfunduar këtë proces. Bashkëpunimi mes arsimit të lartë dhe botës së punës është mjaft i ndërlikuar. Një rol themelor që luan universiteti në shoqëri, gjë që është më se e nevojshme, pra, sigurimi i resurseve njerëzore dhe aktivitetet e hulumtimit për tregun e punës, nuk duhet të neglizhohet. Autonomia e universitetit mund të konsiderohet si një nga arritjet më të mëdha të qytetërimit perëndimor dhe, për këtë arsye, shumë funksione të një universiteti në shoqëri dhe në kulturë duhet të merren parasysh kur transformohet arsimiti i lartë. Ajo mund të shkaktojë dëme afatgjata për punëdhënësit, si dhe për shoqërinë në përgjithësi nëse arsimiti i lartë bëhet subjekt i një ndikimi të pakontrolluar të industrisë dhe kërkesave të tregut të punës.

Përktheu nga anglishtja: Dafina Vezaj

BURIMET DHE BIBLIOGRAFIA

- Bergan, S. (2005): Higher education as a “public good and public responsibility”: what does it mean? In Weber, L. & Bergan, S. eds, (2005) *The public responsibility for higher education and research*. Strasbourg, Council of Europe Publishing.
- Bergen Communiqué (2005): *The European higher Education Area-Achieving the Goals*. Conference of Ministers responsible for Higher Education in 40 European countries (May).
- Bučar, M. (2001): *Razvojno dohitevanje z informacijsko tehnologijo*. Fakulteta za družbene vede, Ljubljana.
- File, J. in Goedegebuure, L. (2003): *On real time systems, change and challenges*. Comparative reflections. V File, J. in Goedegebuure, L. (eds.): *Real-time systems. Reflections on higher education in the Czech Republic, Hungary, Poland and Slovenia*. CHEPS, VUTIUM Press.
- Evropska Komisija (2003): *Vloga univerz v Evropi znanja*. Sporočilo komisije evropskih skupnosti (2003) http://europa.eu.int/eurlex/en/com/cnc/2003/com2003_0058en01.pdf (27. 3. 2005)
- European Commission (2007): *From Bergen to London. The contribution of the European Commission to the Bologna Process*. <http://ec.europa.eu/education/policies/educ/bologna/report06.pdf> (22. 1. 2008)
- Haug, G. (2005): *The public responsibility for higher education: preparation for the labour market*. In Weber, L. & Bergan, S. eds, (2005) *The public responsibility for higher education and research*. Strasbourg, Council of Europe Publishing.
- Keeling, R. (2006): *The Bologna Process and the Lisbon Research Agenda: the European Commission’s expanding role in higher education discourse*. *European Journal of Education*, Vol. 41, No.2, atr. 203-223.
- Knight, P.T. & Yorke, M., (2003a): *Employability and Good Learning in Higher Education*, teaching in Higher Education, Vol. 8, No.1, pp. 3-16.
- Kos, M. (2000): *Menedžment dodane vrednosti*. Teorija in praksa, Ljubljana.
- McNay, I. (2006): *Delivering Mass Higher Education-The Reality of Policy in Practice*. In McNay, I. (ed.) *Beyond Mass Higher Education*, Open university press.
- Miklavič, K: *Bolonjski proces, pot v modernizacijo visokega solstva*. Magistrsko delo. Univerza v Ljubljani, FDV, 2008.

- Mirčeva, J. (2001): Razvoj izobraževanja na področju dela: kanadske izkušnje in raziskovalni pristopi. *Andragoška spoznanja*. Let. 6, št. 1, str. 24-31
- Morley, L. (2003): *Quality and Power in Higher Education*. Society for research into Higher Education in Open University Press.
- Nokkala, T. (2005): Knowledge society/knowledge economy discourse in internationalisation of higher education - A Case study in governmentality. Knowledge and Politics Conference, Bergen, Norway 18th to 20th May 2005.
- Nokkala, T. (2007): *Constructing the Ideal University - The internationalisation of higher education in the comparative knowledge society*. Tampere University Press, Tampere.
- OECD (2007) *Education at a Glance*. Izdal OECD, 2007
- Robertson, S. (2005): Re-imagining and rescripting the future of education: global knowledge economy discourses and the challenge to education systems. *Comparative Education*. Vol. 41, No.3.
- Pawlowski, K. (2004): *Rediscovering higher education in Europe*. UNESCO-CEPES, Bucharest.
- Reichert, S. & Tauch, C. (2005): *European Universities Implementing Bologna*. EUA Trends IV Report (European University Association, Brussels).
- Reichert, S. & Tauch, C. (2003): *Progress towards the European Higher Education Area*. EUA Trends Report. (European University Association, Brussels).
- Teichler, U. (1999): *Internationalisation as a Challenge for Higher Education in Europe*. Tertiary Education and Management 5: 5-23, Kluwer Academic Publishers.
- Teichler, U. (2004): *Changes in the Relationships between Higher Education and the World of Work on the Way towards the European Higher Education Area*. Keynote speech at the EUA Conference "University and Society: Engaging Stakeholders", Marseille, 1-3 April 2004.
- http://www.eua.be/eua/jsp//upload/Ulrich%20Teichler%20speech_1080891100325.doc (10. August 2006)
- Tomusk V. (2003): *The War of Institutions, Episode I: The Rise, and the Rise of Private Higher Education in Eastern Europe*. *Higher Education Policy*, 16 (213-238)
- University of Prishtinë/Priština (2004) *Statute of the University of Prishtinë/Priština*. (Prishtinë/Priština, University of Prishtinë/Priština)
- UNICE (2003): *Lisbon Strategy; Status 2003; Time is Running Out, Action needed now*. <http://212.3.246.117/1/CFNHMHBCFHEM->

[MIAFMEKHPNCAPDB69DB1CG9LI71KM/UNICE/docs/DLS/2003-00589-EN.pdf](http://www.unice.org/1/PGDNNPDC-KGCAAINJHCDHIPMMPDBK9DWWTK9LI71KM/UNICE/docs/DLS/2003-00589-EN.pdf) (30.8.2006)

UNICE (2004): The Bologna Process, UNICE's Position and Expectations (October), <http://www.unice.org/1/PGDNNPDC-KGCAAINJHCDHIPMMPDBK9DWWTK9LI71KM/UNICE/docs/DLS/2004-01874-EN.pdf> (30.8.2006)

UNICE (2005): Position on Commissions Consultation on a European Qualifications Framework for Lifelong-Learning. <http://www.unice.org/1/KCPJHDKCJDHEDKFCNLCKAANNPDB19DWGCY9LI71KM/UNICE/docs/DLS/2005-01981-EN.pdf> (30.8.2006)

Van Damme, D. (2002): Higher Education in the Age of Globalisation. In *Globalisation and the Market in Higher Education*. Unesco publishing. Paris.

Van der Wende, M.C. (2002): Higher Education Globally: Towards New Frameworks for Research and Policy. The CHEPs Inaugurals 2002. University of Twente Cheps (29-69).

Yorke, M. & Knight, P.T., (2003b): The Undergraduate Curriculum and Employability, a briefing paper., http://www.ltsn.ac.uk/application.asp?app=resources.asp&process=full_record§ion=generic&id=248 (10 august 2006)

Zgaga, P. (2004): Bolonjski proces: oblikovanje skupnega evropskega visokošolskega prostora. Univerza v Ljubljani, Pedagoška fakulteta, Ljubljana.